



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 tetor 2017  
Nr. ref.: RK 1144/17

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI135/16

Parashtrues

**Tomislav Janković dhe të tjerët**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-0095, të 6 tetorit 2016**

### GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Tomislav Janković, Živomirka Cvetković, Drenka Popović, Verica Djurdjević, Stojka Janković, Ljiljana Garić dhe Jovica Janković, të gjithë nga Prizreni, tani me banim jashtë Republikës së Kosovës, të cilët përfaqësohen nga avokati Mas-har Pirana nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Vendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-0095, i 6 tetorit 2016 (në tekstin e mëtejme Kolegji i Apelit i DHPGJS), përmes të cilit ishte refuzuar si e palejuar ankesa e parashtruesve kundër Vendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS AC-II-12-0192, i 17 marsit 2016.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe me nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 24 nëntor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata)
6. Më 4 dhjetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 13 dhjetor 2016, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
8. Më 2 qershor 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Më 9 qershor 1961, B. J. nënshkruan kontratën mbi dhuratën përmes së cilës ajo i dhuron patundshmëri Kooperativës bujqësore në Prizren, e cila më vonë u transferua në pronësi të KBI "Progres" nga Prizreni.
10. Më 26 tetor 2006, parashtruesit, si trashëgimtarë të B. J., paraqitën në Gjykatën Komunale në Prizren padi për anulim të kontratës mbi dhurimin e patundshmërive dhe rikthim në posedim.



11. Prej momentit të ushtrimit të padisë deri në vitin 2016, procedurat gjyqësore në gjykatat e rregullta janë zhvilluar dhe kanë rezultuar me vendime të ndryshme gjyqësore.
12. Më 17 mars 2016, Kolegji i Apelit i DHPGJS (Aktgjykimi AC-II-12-0192) aprovoi ankesën e AKP-së dhe anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, nr. C. 811/06 i cili u kishte dhënë të drejtë parashtruesve në kërkesat e tyre pronësore.
13. Më 6 maj 2016, parashtruesit paraqitën në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së ankesë kundër Aktgjykimit AC-II-12-0192.
14. Më 6 tetor 2016, Kolegji i Apelit i DHPGJS me Aktvendimin AC-I-16-0095, refuzoi ankesën e parashtruesve si të palejuar me arsyetimin se vendimet e Kolegjit të Apelit DHPGJS-së, janë vendime të paapelueshme.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

15. Parashtruesit pretendojnë se *“Me Aktvendimin e Panelit të Apelit të Dhomës së Posaçme AC-I-16-0095 të datës 06.10.2016, paditësve iu janë cenuar të drejtat themelore të qytetarëve të mbrojtura me Kushtetutë nga neni 31 pika 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse me Aktgjykimin e ankimuar të Dhomës së Posaçme AC-II-12-0192 të datës 17.03.2016 është vendosur që të mos mbahet seanca dëgjimore në përputhje me nenin 64.1 të Aneksit për Ligjin për Dhomën e Posaçme, me çfarë u janë mohuar të drejtat themelore të paditësve që të deklarojnë dhe arsyetojnë drejtpërdrejt kërkesëpadinë e tyre para Kolegjit të Apelit”.*
16. Parashtruesit më tej pretendojnë gjithashtu se *“në arsyetimin e Aktgjykimit të Kontestuar AC-II-12-0192 të datës 17 mars 2016, në faqen 2 dhe në faqen 3, në ankesën e AKP-së të datës 05.05.2010 paraqitën të thëna të imagjinuara, që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, pretendohet të ketë shkelje esenciale të dispozitave të nenit 181, pika 1, a. b. dhe c. Si dhe neni 183 dhe neni 184 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, e që nuk është e vërtetë”.*
17. Në fund, parashtruesit i propozojnë Gjykatës Kushtetuese që të shpallë jo kushtetues Aktvendimin AC-I-16-0095 dhe Aktgjykimin AC-II-12-0912 dhe që lënda të kthehet në rivendosje.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

18. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, i cili përcakton:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*



20. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson nëse parashtruesit e kanë paraqitur kërkesën brenda afatit të përcaktuar kohor me këtë rast i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh: *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”*.
21. Në mënyrë që të verifikojë nëse parashtruesit kanë parashtruar kërkesën brenda afatit të caktuar prej 4 (katër) muajsh, Gjykata i referohet datës së pranimit të vendimit të fundit nga ana e parashtruesve dhe datës së dorëzimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.
22. “Vendimi i fundit”, sipas nenit 49 të Ligjit, normalisht do të jetë vendimi i fundit me të cilin ishte refuzuar padia e parashtruesve (Shih *Paul dhe Audrey Edëards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, GJEDNJ, *Vendim i 14 marsit 2002*).
23. Afati fillon të llogaritet nga vendimi i plotfuqishëm, si rezultat i shterjes së mjeteve adekuate dhe efektive për të siguruar korigjimin e çështjes, që është objekt i ankesës (Shih *Norkin kundër Ruisë*, Kërkesa 2105/11, GJEDNJ, Vendimi i 5 shkurtit 2013 dhe shih, gjithashtu, *Moya Alvarez kundër Spanjës*, nr. 44677/98, GJEDNJ, Vendimi i 23 nëntorit 1999).
24. Përkitazi me ankesën e ushtruar kundër Aktgjykimit AC-II-12-0192, të 17 marsit 2016, Gjykata vëren se në bazë të nenit 10, paragrafi 14, të Ligjit nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit *“të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër”*.
25. Në rrethanat e rastit konkret, është e qartë se ankesa kundër Aktgjykimit AC-II-12-0192, të 17 marsit 2016 nuk ka qenë mjet efektiv juridik dhe se nuk mund të kishte pritshmëri për suksesin e këtij mjeti sepse qartazi me ligj ishte përcaktuar se ai mjet juridik nuk ishte i lejueshëm të ushtrohej.
26. Për arsytet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se vendimi i fundit në rastin konkret është Aktgjykimi AC-II-12-0192 i Kolegjit të Apelit DHPGJS-së dhe afati fillon të llogaritet nga dita e pranimit të aktvendimit të lartpërmendur nga ana e përfaqësuesit të parashtruesve (Shih mutatis mutandis *Bayram dhe Yildirim kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 38587/97, GJEDNJ, Vendimi i 29 janarit 2002).
27. Prandaj, nga shqyrtimi i dosjes së lëndës rezulton se parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar Aktgjykimin AC-II-12-0192, më 18 prill 2016, ndërsa kërkesën në Gjykatë e kanë dorëzuar më 24 nëntor 2016 (shih, ndër të tjera, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese KI105/15, të parashtruesve *Mehmet Bajraktari dhe të tjerët*, të 19 dhjetorit 2016).
28. Në rrethanat kur kërkesa është qartazi e paafatshme, Gjykata nuk mund të shqyrtojë pretendimet e ngritura lidhur me shkeljet e pretenduara të së drejtës për gjykim të drejtë në të gjitha elementet e saj.

29. Bazuar si më sipër, rrjedh se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe duhet të deklarohet e papranueshme, sepse është e paafatshme.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (c) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 qershor 2017, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Arta Rama-Hajrizi

